



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E KULTURËS
AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK**

Lënda: LISTA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR QË DUHET DORËZUAR PËR PROJEKTE ZHVILLIMORE RIKONSTRUKSION RRUGE EKZISTUESE (RRJETE SHERBIMI, ELEKTRIKE, TELEFONIE ETJ), NË ZONAT ARKEOLOGJIKE "A" DHE "B " TË QYTETEVE

Kjo listë ka vetëm vlerë orientuese, në çdo rast ASHA do të vlerësojë aplikimin dhe do të përcaktojë rast pas rasti në varësi të projektit që do të zhvillohet dhe zonën përkatëse, dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.

- 1. Kërkesë për miratim projekti** e firmosur nga investitori, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose me prokurë. Nëse kërkesa është firmosur nga përfaqësues me prokurë, kjo e fundit të jetë hartuar para noterit dhe të depozitohet në formën e kërkuar nga ligji (origjinale ose e noteruar).
- 2. Pagesa e tarifës së aplikimit** miratuar me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015.
- 3. Projekti teknik ndërtimor i rrugës (rrjetit)**, firmosur nga projektuesi i licencuar, shoqëruar me CD e këtij projekti dhe PowerPoint i tij. Projekti përmban:
 - a. Hartën në ortofoto 2015/2007** apo topografike shkallë 1:10000/1:25000, me kufinj të zonave arkeologjike "A" dhe "B" ku të jetë hedhur planvendosja e rrugës dhe objekteve të saj (rrjetit dhe objekteve të tij), ku do të kryhen punimet. Harta të jetë e **printuar nga sistemi WebGIS**.
 - b. Planet për segmente të ndryshme rrugore (të rrjetit)**, profilet gjatësorë dhe tërthorë, detaje të ndërtimit që tregojnë thellësinë e gërmimeve. (sipas llojit të punimeve)
- 5. Relacioni teknik shpjegues i projektit të ndërtimit** i firmosur nga projektuesi i licencuar.